



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Senati i Universitetit

Pejë, 23.3.2026

Mbështetur në nenet 42, 47 dhe 48 të Statutit Nr. 04-V-622, datë 30.5.2013 dhe Kërkesën me nr. 545, datë 9.3.2026 të Parlamentit të Studentëve, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka", në mbledhjen e mbajtur me datë 18.3.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Lejohet organizimi i afatit të prillit, si afat plotësues për organizimin e provimeve nga njësitet akademike, për studentët e niveleve Bachelor dhe Master, të regjistruar në vitin akademik 2025/26.
- II. Në afatin plotësues të prillit, studentët kanë të drejtë të paraqesin provime pa kufizim në numër, duke respektuar kërkesat e syllabusit dhe të planit mësimor. Në kuptim të kësaj pike, përfshihet edhe provimi përfundimtar ose i diplomës.
- III. Afati për paraqitjen e provimeve do të jetë i hapur nga 1.4.2026 deri më 10.4.2026. Organizimi i mbajtjes së provimeve do të bëhet sipas orareve të hartuara dhe të publikuara nga njësitet akademike përkatëse, duke siguruar vazhdimësi të rregullt të aktiviteteve të tjera akademike dhe institucionale.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit.

Arsyetim

Senati i Universitetit "Haxhi Zeka", në mbledhjen e datës 18.3.2026, ka shqyrtuar Kërkesën me nr. 545, datë 9.3.2026 të Parlamentit të Studentëve, për lejimin e mbajtjes së afatit të prillit si afat plotësues për paraqitjen e provimeve nga studentët e regjistruar në vitin akademik 2025/26.

Duke marrë në konsideratë nevojën për t'u ofruar studentëve një mundësi shtesë dhe gjithëpërfshirëse për realizimin e obligimeve akademike, pa kufizim në paraqitjen e provimeve, përfshirë edhe provimin përfundimtar/të diplomës, Senati ka vlerësuar se kërkesa është e bazuar dhe e arsyeshme.

Mbështetur në atë çfarë u tha më lart, u vendos si në dispozitiv.

T'u dërgohet:

- Parlamentit të Studentëve;
- Anëtarëve të Senatit;
- Sekretarëve të njësive akademike;
- Zyrës për Çështje të Studentëve;
- Zyrës për Çështje Akademike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie;
- Zyrës së Teknologjisë së Informacionit;
- Zyrës për Protokoll dhe Arkiv.

Senati:

Prof. Dr. Armand Krasniqi, kryesues

